



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK
ELBASAN**

Nr **388** Prot

Elbasan më, 16.06.2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional".

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofrimit Formimit Profesional Publik Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin:

- Instruktor/e Gjuhe e huaj Gjermane (1) person
- Instruktor/e Aftësi Dixhitale (1) person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vëpuar;
- b) Të jetë në kushtë shëndetësorë që e lejojnë të kryesj detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ket ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;

f) Të demostrojë aftësi të punës ne grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplome nga nje shkolle e mesme profesionale ose kualifikim personal pas te mesem ne profesionin e kursit qe aplikon.
- b) Të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në fushen, në te cilen eshte kualifikuar.
- c) Të njohë dhe të përdor teknologjinë e informacionit

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit te vendit te lire , duhet te perfshije.

- letermotivimin për pozicionin:
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e indentitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dukmentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jeteshkrim;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim i gjendjes shendetesore
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2. Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Dokumentet ne gjuhen e huaj duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen ne protokollin e ofrusit të AFP-së brenda dates 05.07.2023,

DREJTOR

Krenar XHEMALI

